



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 389 Akti

Nr. 398.Vendimi
Tiranë, më 11.6.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Valbona Sanxhaktari	Kryesuese
Olsi Komici	Relator
Xhensila Pine	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin, në datën 11.6.2021, ora 09:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Luveda Dardha**, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: **Neni 179/ b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore paraqitur nga subjekti për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit dhe dëgjoi subjektin e rivlerësimit, në seancën dëgjimore dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Luveda Dardha, është subjekt rivlerësimi, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë për shkak të funksionit të saj si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.
2. Subjekti i rivlerësimit u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit në përputhje me rregulloren¹, duke u shortuar me trupin gjykues përbërë nga komisionerët Valbona Sanxhaktari, Olsi Komici dhe Xhensila Pine. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioneri Olsi Komici.
3. Trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ bazuar në nenin 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Luveda Dardha, mbi vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe rivlerësimin e aftësisë profesionale, si dhe caktoi kryesuese komisioneren Valbona Sanxhaktari.
4. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues.
5. Me hedhjen e shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ).
6. Trupi gjykues, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Luveda Dardha, si dhe e njoftoi për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 – 47, të Kodit të Procedurave Administrative dhe për të paraqitur prova dhe shpjegime për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit të dërguara nga Komisioni.
7. Subjekti i rivlerësimit në datën 20.5.2021, me anë të postës elektronike, njoftoi Komisionin se është në pamundësi për paraqitjen e shpjegimeve dhe sigurimin e provave, si dhe kërkoi shtyrje të afatit për të dërguar përgjigjet për rezultatet e hetimit të dërguar nga Komisioni.
8. Komisioni, me anë të postës elektronike, njoftoi subjektin Luveda Dardha mbi pranimin e kërkesës për shtyrje për të sjellë shpjegimet e shoqëruara me prova, duke e njoftuar se afati i ri për sjelljen e provave dhe shpjegimeve ishte më 3.6.2021.
9. Subjekti i rivlerësimit, brenda afatit të caktuar, depozitoi provat dhe shpjegimet, të cilat u administruan dhe u analizuan nga trupi gjykues.

II. SEANCA DËGJIMORE

10. Trupi gjykues ftoi subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore në datën 9.6.2021, ora 14:00.

11. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në Sallën e Konferencave, në Pallatin e Koncerteve, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin.

¹ “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

12. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht, parashtroi shpjegimet, si dhe kërkoi konfirmimin e saj në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

13. Subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpunuese gjatë gjithë procesit administrativ në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

IV. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

14. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Luveda Dardha, ku në përfundim të veprimeve verifikuese, ka konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *dokumentacion jo i plotë ligjor për të justifikuar burimin financiar të huadhënies nga babai;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

15. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, si dhe të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, për: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e fshehjes të mundshme të pasurive në pronësi apo përdorim; dhe (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë situatë konflikti interesi, të parashikuar në pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, nga ku rezultoi se:

1. Lidhur me apartamentin me sip. 80 m² dhe 9.7 m² sipërfaqe e përbashkët, Tiranë

16. Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* pasurinë apartament me sipërfaqe totale 80 m², me vendndodhje në rrugën “****”, h. ***, ap. ***, Tiranë. Çmimi i blerjes së apartamentit 80.000 euro, sipas kontratës së shitblerjes së pasurisë nr. ***, datë 24.8.2016.

17. Burimi i krijimit i deklaruar në deklaratën *Vetting*: (i) të ardhurat nga kredia e marrë në “Credins Bank”, në shumën 7.000.000 lekë e konvertuar në 50.000 euro, sipas kontratës së kredisë, datë 17.6.2016; (ii) të ardhura nga huaja e marrë prindërve në shumën 28.000 euro sipas kontratës së huas, datë 4.1.2017; (iii) të ardhura nga paga personale dhe e bashkëshortit për vitin 2016 në shumën 2.000 euro.

18. Me kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme, datë 24.8.2016, pala shitëse, shoqëria ndërtuese “****” sh.p.k. i ka shitur palës blerëse, shtetasve A.A. dhe Luveda Dardha, apartamentin me sip. 80 m² dhe 9.7 m² sipërfaqe e përbashkët, ndodhur në rrugën “****”, Tiranë.

19. Çmimi i blerjes së apartamentit përcaktohej në nenin 2 të kontratës në vlerë 80.000 euro, dhe blerësit deklarorin se e kanë shlyer jashtë zyrës noteriale me këste, të gjithë shumën objekt kontrate porosie, datë 25.5.2016.

Analiza e burimeve të krijimit për këtë pasuri

i) Kredia në shumën 7.000.000 lekë, si burim krijimi

20. Subjekti ka depozituar kontratën e kredisë së datës 17.6.2016 me palë kredidhënëse “Credins Bank”, me palë kredimarrëse znj. Luveda Dardha dhe dorëzanës z .A.A., për shumën 7.000.000 lekë me qëllim blerje apartamenti.

21. Kredia u disbursua me dy këste si vijon:

- kësti i parë i kredisë në shumën prej 5.800.000 lekësh; dhe
- kësti i dytë i kredisë në shumën prej 1.200.000 lekësh.

22. Kjo kontratë kredie u garantua nga kontrata e hipotekës, datë 17.6.2016, me hipotekues prindërit e subjektit L. dhe N.D., të cilët bllokuan në favor të kredidhënësit “Credins Bank” pasurinë apartament me sip. 60 m², në pronësi të tyre.

23. Më pas është lidhur kontrata e hipotekimit, datë 6.10.2016, ku kredidhënësi “Credins Bank” u garantua nga shtetasit Luveda Dardha dhe A.A. me pasurinë me sip. 80 m², në rrugën “***”, Tiranë, në pronësi të tyre.

24. Nga hetimi administrativ nuk u konstatuan problematika lidhur me burimin e krijimit – kredinë bankare.

ii) Hua nga prindërit e subjektit - deklaruar si burim krijimi

25. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se si burim krijimi për blerjen e apartamentit ka përdorur hua nga prindërit në shumën 28.000 euro, sipas kontratës së datës 4.1.2017.

26. Kontrata e huas, datë 4.1.2017, kishte për objekt dhënien hua të shumës 36.000 euro nga pala huadhënëse babai i subjektit, z. L.D., te pala huamarrëse subjekti i rivlerësimit znj. Luveda Dardha dhe z. A.A., me qëllim blerjen nga huamarrësit të një apartamenti banimi në rrugën “***”, Tiranë.

27. Kontrata e huas, datë 4.1.2017, përcaktonte se shuma e dhënë hua nga huadhënësi babai i subjektit, z. L.D., ishte si rezultat i të ardhurave të tij duke i specifikuar ato si vijon:

- a. të ardhurave të përfituara nga aktiviteti tregtar privat në tregun e lirë industrial të zhvilluar në qytetin e Fierit për periudhën 1993 - 2001, së bashku me bashkëshorten e tij;
- b. të ardhurat nga emigracioni në shtetin grek;
- c. të ardhurat nga shitja pasurisë së paluajtshme apartament me sip. 88 m² në vitin 2002, në Tiranë; si dhe
- ç. shitja e apartamentit në qytetin e Fierit, në vitin 2001.

28. Shuma 36.000 euro është derdhur *cash* nga pala huadhënëse babai i subjektit, z. L.D., në llogarinë rrjedhëse të palës huamarrëse, subjektit Luveda Dardha në “Credins Bank”.

29. Kontrata e huas, datë 4.1.2017, përcaktonte se një pjesë e shumës së marrë hua, prej 8.000 euro, ishte shlyer nga huamarrësit kundrejt huadhënësit në tetor të vitit 2016 me disbursimin e kështit të dytë të kredisë në shumën 1.200.000 lekë.

30. Kontrata e huas, datë 4.1.2017, përcaktonte se pjesa e mbetur e huas në shumën 28.000 euro do t’i kthehej huadhënësit nga palët huamarrëse pa afat kohor, në vitet në vazhdim, marrë në konsideratë lidhjen familjare midis palëve, sipas mundësive ekonomike të huamarrësve, pasi të ardhurat e tyre përbëhen vetëm nga të ardhurat nga pagat personale.

31. Interesi pasuror në marrëdhënien e huamarrjes ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe babait të saj, i cili deklarohet si huadhënës dhe konfirmon marrëdhënien e huas, me kontratën e huas, datë 4.1.2017, sipas përcaktimit të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, passjell për efekt të procesit të rivlerësimit, detyrimin e subjektit të provojë burimin e ligjshëm të pasurisë së personit tjetër të lidhur, përfshirë në marrëdhënien e konfirmuar të huas.

32. Në këto kushte, trupi gjykues i kërkoi subjektit të provojë me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm në lidhje me të ardhura në shumën 36.000 euro sipas deklarimit të huadhënësit.

33. Subjekti ka shpjeguar burimin e palës huadhënëse për shumën e dhënë hua si vijon:

i) Të ardhurat e prindërve të përfituara nga aktiviteti tregtar

34. Për sa u përket të ardhurave të përfituara nga ky aktivitet privat dhe detyrimeve tatimore të paguara, subjekti ka sqaruar se prindërit L. dhe N.D., për periudhën kohore në fjalë, nuk kanë qenë subjekte të regjistruara në organet tatimore, si dhe nuk kanë pasur detyrimin për t'u regjistruar, por paguanin vetëm një tarifë ditore kundrejt Bashkisë Fier për zënien e vendit për ushtrimin e aktivitetit.

ii) Të ardhurat e babait nga emigracioni në shtetin grek

35. Për sa u përket të ardhurave të përfituara nga emigracioni në shtetin grek, subjekti ka deklaruar se përbëjnë një pjesë të vogël, ku babai i subjektit L.D. ka punuar në vitin 1994 dhe 1995, vetëm në sezone verore, por nuk disponon dokumentacion provues, pasi është periudhë e hershme dhe nuk ka qenë i siguruar.

iii) Të ardhurat nga shitja e apartamentit në qytetin e Tiranës në vitin 2002

36. Për sa i përket shitjes së një pasurie të paluajtshme në qytetin e Tiranës, nga babai i subjektit L.D., janë realizuar të ardhura në vlerën 2.000.000. Subjekti ka sqaruar edhe mbi vitin e përfitimit të këtyre të ardhurave nga babai, duke saktësuar se viti 2002 i vendosur në deklaratën e babait është i gabuar dhe se këto të ardhura janë përfituar prej tij në vitin 2005.

iv) Të ardhurat nga shitja e apartamentit në qytetin e Fierit, në vitin 2001

37. Për sa i përket shitjes së një pasurie të paluajtshme në qytetin e Fierit, nga babai i subjektit L.D., janë realizuar të ardhura në vlerën 1.500.000 lekë.

38. Komisioni kreu analizën financiare, lidhur me mundësinë financiare të huadhënësit (babai i subjektit), për të krijuar shumën 36.000 euro dhënë hua subjektit, nga e cila rezultoi se personi i lidhur/babai i subjektit ka pasur mundësi me të ardhura të ligjshme të japë hua shumën 36.000 euro.

39. Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të paraqitur shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit të Komisionit, lidhur me sa duket se:

- ka pasaktësi në deklarin lidhur me burimin e krijimit për blerjen e apartamentit, deklaruar në deklaratën *Vetting* nga subjekti i rivlerësimit, mbi deklarinin si burim të huas së dhënë në shumën 28,000 euro, ndërkohë që në kontratën e huas, datë 4.1.2017, rezulton e dhënë hua shuma 36.000 euro;

- duket se nuk provohet burimi i huas nga personi tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit, babai i saj, në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës;

- duket se nuk provohet që depozitat e tërhequra në vitin 2004 të jenë burim krijimi i huas së dhënë në shumën 36.000 euro në vitin 2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

40. Subjekti i rivlerësimit, në prapësime lidhur me saktësinë e deklarimit të huas, ka shpjeguar se lidhur me deklarimin e vlerës së huas është shënuar shuma prej 28.000 euro, pasi aq ka qenë detyrimi i mbetur ndaj huadhënësit në kohën e paraqitjes së deklaratës *Vetting* në datën 26.1.2017.

41. Shuma 8.000 euro ishte shlyer nëpërmjet disbursimit të kredisë, fakt që është pasqyruar edhe në përmbajtjen e kontratës së huas, si dhe në mënyrën e lëvrimit të kredisë edhe në deklaratën *Vetting* në rubrikën “të dhëna konfidenciale”.

42. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të dhëna hua nga prindërit e saj, ka shpjeguar se nga shuma totale prej 36.000 euro (e konvertuar në 4.963.680 lekë), që i është dhënë hua, shuma 2.500.000 lekë është përfituar nga shitja e apartamenteve konkretisht: shuma prej 2.000.000 lekësh e përfituar nga shitja e apartamentit në qytetin e Tiranës; dhe shuma prej 500.000 lekësh, e përfituar nga shitja e apartamentit në qytetin e Fierit. Pra, në total 2.500.000lekë, janë të ardhura të përfituara nga prindërit e subjektit, për të cilat është paguar detyrimi tatimor dhe, si të tilla, duhet të konsiderohen si burim i ligjshëm për një pjesë të huas në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

43. Për të provuar faktin e ushtrimit të aktivitetit tregtar nga dy prindërit, në kushtet kur ky treg nuk ekziston, subjekti ka paraqitur si provë dhe deklaratën noteriale të datës 24.5.2021² nga shtetasi M.D., i cili ka deklaruar se ka qenë me detyrë inspektor taksash në Bashkinë Fier për periudhën1993 – 2001, me shkëputje në vitin 1997 dhe se z. L.D. së bashku me bashkëshorten kanë punuar së bashku te “Tregu industrial”.

44. Në këto kushte, për shkak të kohës së gjatë të kaluar, duke mos pasur detyrimin e ruajtjes së dokumentacionit, sikurse fatura për blerjen apo shitjen e mallrave përkatës, si dhe mos ruajtja e biletave ditore në favor të Bashkisë Fier, e vetmja provë e drejtpërdrejtë është depozitimi i kursimeve prej tyre në bankë.

45. Edhe në pikën 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se: “*Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive, për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t’i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri, ose nuk mund merret në rrugë tjetër*”.

46. Subjekti theksoi se në bazë të ligjeve të kohës prindërit si persona të lidhur nuk kanë pasur ndonjë detyrim ligjor për ta pasur të depozituar këtë shumë në sistemin bankar, por si çdo qytetar i kanë tërhequr për shkak se interesat në bankë kanë qenë të ulëta dhe për arsye të tjera.

47. Ndodhur në kushtet e pamundësisë për të provuar burimin e ligjshëm për një pjesë të shumës së marrë hua prej 2.463.680 lekësh, lidhur me mungesën e dokumentacionit për pagimin e detyrimit tatimor nga personi i lidhur, huadhënësi, në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjekti deklaroi se duhet të merren në konsideratë shpjegimet së bashku me provat e paraqitura sa më sipër, duke u llogaritur në analizën financiare si një burim i ligjshëm.

² Deklarata noteriale nr. ***, datë 24.5.2021, me deklarues M.D.: “ [...] kam qenë inspektor taksash pranë Bashkisë Fier, nga viti 1991 – 2001, me shkëputje në vitin 1997. Me vullnetin tim të lirë dhe të plotë, deklaroj se nga muaji tetor i vitit 1993 deri në muajin gusht të vitit 2001, shtetasi L.D., i datëlindjes 3.5.1957, së bashku me bashkëshorten e tij, N.D., e datëlindjes 27.11.1960, kanë punuar së bashku me ne në tregun industrial me pakicë dhe shumicë në Fier dhe kanë paguar rregullisht taksat e Bashkisë Fier për aktivitetin që kanë kryer”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

48. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në “Deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*”; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provave shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

a) Lidhur me saktësinë e deklaratimit të subjektit të rivlerësimit në deklaratën *Vetting*

49. Subjekti i rivlerësimit, duke mos deklaruar saktë vlerën e huas marrë nga prindërit përdorur si burim krijimi për prenotimin e këtij apartamenti, ka vepruar në kundërshtim me pikat 2 dhe 3, të nenin D, të Aneksit të Kushtetutës, pikat 1 dhe 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, si dhe udhëzimin e ILDKPKI-së, datë 10.10.2016, të cilët detyrojnë subjektin e rivlerësimit jo vetëm për deklaratimin e “pasurisë” por edhe të “burimit” në momentin e krijimit të saj.

50. Në lidhje me pretendimin e subjektit, se ka deklaruar vlerën e mbetur të detyrimit ndaj prindërve, vlerësohet si një pretendim i papranueshëm, për sa kohë dispozitat kushtetuese dhe parashikimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës përcaktojnë në mënyrë të qartë detyrimin e subjekteve të rivlerësimit për të deklaruar me saktësi dhe vërtetësi pasuritë në pronësi, burimet e krijimit të tyre, pra, të ardhurat financiare që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie, pra të “burimit” në momentin e krijimit të saj.

51. Subjekti i rivlerësimit në pjesën “Deklarimi i pasurisë” të deklaratës së pasurisë *Vetting* të vitit 2017, ka deklaruar si burim krijimi të këtij apartamenti: huan bankare. Nëse mënyra e të kuptuarit të subjektit të rivlerësimit do të ishte deklarimi vetëm i huave të pashlyera në momentin e dorëzimit të deklaratës së pasurisë *Vetting*, atëherë edhe për huan bankare do të duhej të deklaronte si burim krijimi të kësaj pasurie vetëm vlerën e pashlyer deri në datën e deklaratimit dhe jo totalin sikundër e ka deklaruar.

52. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se pasaktësia në deklaratimin e subjektit të rivlerësimit në deklaratën *Vetting*, lidhur me vlerën e huas marrë nga prindërit, përdorur si burim krijimi për apartamentin, e bën deklaratimin e subjektit në këtë rast të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve në pikat 1, 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 33, pika 5, germa “a” dhe 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016.

b) Lidhur me ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive dhënë hua

53. Në vlerësimin e trupit gjykues, kualifikimi i prindërve të subjektit të rivlerësimit si persona të tjerë të lidhur, sipas përkufizimit të dhënë në pikën 14, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, passjell detyrimin e subjektit të rivlerësimit, që për efekt të procesit të rivlerësimit të provojë burimin e ligjshëm të pasurisë së personit tjetër të lidhur, për pasurinë e përfshirë në marrëdhënien e konfirmuar të huas. Trupi gjykues vlerëson se subjekti, pas rezultateve të hetimit, ka bërë një kualifikim të burimeve të huas, i cili nuk përputhet me parashikimet e kontratës së huas së nënshkruar mes palëve. Për sa më sipër referuar, trupi gjykues vlerësoi të analizojë ligjshmërinë e secilit prej burimeve të deklaruara gjatë nënshkrimit të kontratës së huas, si vijon.

54. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit, në lidhje me të ardhurat e prindërve të përfituara nga aktiviteti tregtar, arriti në përfundimin se ato nuk gjejnë mbështetje në dokumentacion, duke arsyetuar si vijon:

55. Komisioni vëren se të ardhurat e realizuara nga prindërit nga aktiviteti tregtar ambulant në vitet 1993 – 2001 nuk mund të merren në konsideratë, pasi kanë karakter deklarativ dhe nuk

janë të bazuara në dokumentacion provues ligjor për vlerën dhe kohën e krijimit të këtyre të ardhurave të pretenduara, si dhe pagesën e detyrimeve përkatëse tatimore.

56. Subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar asnjë dokumentacion ligjor që të provojë ushtrimin e aktivitetit tregtar ambulant nga prindërit në vitet 1993 – 2001, përveç depozitimit të deklaratës noteriale, ku shtetasit N.T. dhe M.K. kanë deklaruar faktin se prindërit e subjektit kanë ushtruar aktivitet tregtar në tregun industrial Fier për këtë periudhë, por kjo deklaratë ka karakter deklarativ dhe nuk provon realizimin e të ardhurave të pretenduara të ligjshme të pikës 3, të nenit D, të Aneksi i Kushtetutës.

57. Deklarata noteriale e shtetasve N.T. dhe M.K. mund të provojë faktin se prindërit e subjektit kanë zhvilluar aktivitet tregtar ambulant në periudhën e pretenduar, por nuk mund të provojnë kurrsesi të ardhurat e përfituara nga ky aktivitet, nga babai i saj.

57.1 Deklarata noteriale e shtetasve N.T. dhe M.K. e pashoqëruar me dokumentacion zyrtar nga organet kompetente, për nga vlera provuese është e barabartë me deklaratimet e subjektit të rivlerësimit.

58. Gjithashtu, Komisioni vëren se referuar legjislacionit të kohës, ligjit nr. 7679, datë 3.3.1993, “Për tatimin mbi biznesin e vogël”, personat fizikë që ushtrojnë veprimtari private të pavarur me qëllime fitimprurëse në tregti, në artizanat, në shërbime të ndryshme si transport, shëndetësi, avokaturë dhe në shërbime të tjera, i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat që realizojnë. Në nenin 4 të këtij ligji përcaktohet se: “*Personat fizikë që ushtrojnë veprimtari ambulante e forma të tjera të kësaj natyre, paguajnë tatim vjetor me kuotë fikse*”, sipas veprimtarisë që kanë ushtruar.

59. Ligji nr. 8313, datë 26.3.1998, “Për tatimin mbi biznesin e vogël”, përcakton si kategori tatimpaguesish edhe shitësit ambulantë të cilët paguajnë kuotë fikse³. Po ky ligj sanksionon⁴ përgjegjësinë e tyre për regjistrim.

60. Subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë me dokumentacion të ardhurat e pretenduara si të realizuara nga prindërit e saj për periudhën tetor 1993 – gusht 2001, si dhe ushtrimin e aktivitetit tregtar ambulant, për pasojë Komisioni nuk i merr në konsideratë këto të ardhura në analizën financiare për vlerësimin e mundësisë së krijimit të shumës 36.000 euro, qëndrim ky i mbajtur nga Kolegji i Posaçëm i Apelit⁵.

61. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për pamundësi objektive, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se që subjekti të jetë në kushtet e pamundësisë objektive për të disponuar dokumentin që justifikon dhe ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t’i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër, gjë që nuk u arrit të provohej nga subjekti i rivlerësimit.

62. Në këto kushte, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë me dokumentacion të ardhurat e pretenduara si të realizuara nga prindërit si tregtarë ambulantë dhe ato nuk mund të përfshihen në analizën financiare lidhur me mundësinë e prindërve për krijimin e vlerës 36.000 euro, dhënë hua subjektit të rivlerësimit.

63. Lidhur me të ardhurat e babait nga emigracioni në shtetin grek, deklaruar si burim në kontratën e huas nga subjekti, gjatë hetimit është vetëdeklaruar se nuk ka qenë i siguruar. Lidhur me deklarimin e subjektit se këto të ardhura zënë një pjesë të vogël të huas, trupi gjykues

³ Kreu II, neni 3, pika E1.

⁴ Neni 9, pika “dh”, përbëjnë kundërvajtje administrative këto shkelje: “...pika ‘dh’ mosparaqitja e certifikatës së regjistrimit nga tatimpaguesit ambulantë, kur ajo kërkohet nga organi tatimor”.

⁵ Vendim nr. 21/2020 (JR), datë 10.9.2020, subjekti i rivlerësimit R. J., pikat 66 - 68.

nuk e gjen bindës këtë deklaram dhe ndarje të subjektit, pasi për sa janë deklaruar si burim për këtë hua, nuk mund të përjashtohen nga analiza mbi ligjshmërinë e krijimit si detyrim kushtetues i palëve në proces.

64. Trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se të ardhurat e realizuara nga babai nga emigracioni në shtetin grek nuk kanë qenë të ligjshme, për arsye se për to nuk janë paguar detyrimet tatimore. Në këto kushte, trupi gjykues arrin në konkluzionin se ato nuk mund të përfshihen në analizën financiare lidhur me mundësinë e prindërve të subjektit për krijimin e vlerës 36.000 euro, dhënë hua subjektit të rivlerësimit.

65. Lidhur me të ardhurat nga shitja e apartamenteve në Tiranë dhe në Fier, me të cilat subjekti pretendoi se ishte krijuar një pjesë e shumës totale prej 36.000 euro.

66. Nga hetimi administrativ trupi gjykues vlerëson të nënvizojë sa rezultoi se:

a) prindërit e subjektit kanë pasur në pronësi një apartament banimi në qytetin e Fierit, nga i cili kanë përfituar të ardhura nga shitja në vitin 2001, në vlerën 1.500.000 lekë;

b) prindërit e subjektit kanë blerë pas shitjes së apartamentit në Fier një apartament në Tiranë, në datën 18.1.2002, në vlerën 1.000.000 lekë, duke rezultuar se kanë pasur mundësi për të krijuar likuiditete nga shitja dhe blerja e apartamenteve me sipër në vlerën 500.000 lekë, si diferencë e çmimit të shitjes së apartamentit në Fier me çmimin e blerjes së apartamentit në Tiranë;

c) nga shitja e këtij të fundit (apartamentit në Tiranë), prindërit kanë përfituar të ardhura në vlerën 2.000.000 lekë;

ç) prindërit e subjektit në vijim, pas shitjes së apartamentit në Tiranë, kanë blerë në datën 28.3.2006 një apartament tjetër në vlerën 19.800 euro, vlerë e përafërt me vlerën e likuiditeteve të përfituara nga shitblerjet e pronave të mëparshme.

67. Nga vlerësimi i situatës faktike financiare të prindërve të subjektit, trupi gjykues vlerëson se referuar shitblerjeve të mësipërme të pronave të paluajtshme nga prindërit e subjektit, nuk provohet se ata kanë pasur likuiditete gjendje për dhënien e huas subjektit, pasi të ardhurat e përfituara prej tyre nga shitja e pasurive të paluajtshme janë riinvestuar në blerjen e pasurive të tjera të paluajtshme.

68. Fragmentimi i bërë nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me shitblerjet e pronave të paluajtshme nga ana e prindërve të saj, duke u ndalur te shitja e apartamentit të parë në Tiranë, pa marrë në konsideratë në vlerësimin e gjendjes financiare se pas shitjes së tij prindërit blenë një apartament tjetër në Tiranë, nuk provon se ata kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për të krijuar pasuritë likuiditete, dhënë hua subjektit të rivlerësimit.

69. Trupi gjykues arrin në përfundimin se në raport me legjislacionin e zbatueshëm, në përputhje me parashikimet ligjore që rregullojnë këtë status, subjekti nuk ka arritur të provojë me asnjë dokumentacion ligjor provues se si burim krijimi i huas së dhënë në shumën 36.000 euro në vitin 2016 kanë shërbyer të ardhura të përfituara nga prindërit nga shitblerjet e pronave.

70. Gjithashtu, ky konkluzion i trupit gjykues bazohet edhe në sa ka rezultuar mbi depozitat e tërhequra në vitin 2004 deklaruar si burim krijimi i huas së dhënë në shumën 36.000 euro në vitin 2016 si vijon:

71. Nga hetimi rezultoi se prindërit e subjektit të rivlerësimit kanë hapur dy llogari bankare përkatësisht në shtator dhe tetor të vitit 2003 dhe i kanë mbyllur ato në janar të vitit 2004. Në këto llogari ka pasur likuiditet në shumën prej 56.000 USD deri në janar të vitit 2004.

71.2. Këto likuiditete janë tërhequr nga llogaritë bankare në janar të vitit 2004 dhe pretendimet e subjektit se kanë qenë pikërisht këto shuma që i janë dhënë asaj hua në vitin 2016 nuk gjetën mbështetje, pasi mënyra e përfitimit/transaksioni i kryer nuk rezultoi i provuar në ndonjë

formë. Trupi gjykues vlerëson si të rëndësishme ekzistencën e një lidhjeje midis shumë s të përfituar në formë huaje në vitin 2016 dhe burimit të deklaruar nga subjekti rivlerësimit, i cili nga hetimi rezultoi se ishte tërhequr që në janar të vitit 2004.

71.3. Duke qenë se procesi i rivlerësimit i ngarkon subjektet me përgjegjësi për të provuar ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të përdorura për krijimin e pasurive, subjekti i rivlerësimit në këtë rast dështoi të bindte trupin gjykues se kjo hua e kishte burimin pikërisht nga të ardhurat që ndodheshin në bankë rreth 12 vjet më parë, të cilat ishin tërhequr nga prindërit.

71.4. Trupi gjykues vlerëson se nuk ka një logjikë të besueshme në deklaratimet e subjektit se prindërit e saj erdhën nga qyteti i Fierit për të banuar në Tiranë dhe depozituan të ardhurat e kursimet e tyre në bankë, të cilat i tërhoqën pothuajse menjëherë, dhe, më tej, i mbajtën ato në banesë për një afat kohor prej rreth 12 vjetësh, deri sa ia dhanë hua vajzës së tyre.

71.5. Në vlerësim të fakteve dhe rrethanave të rezultuara gjatë hetimit dhe investime të kryera prej prindërve, ndër vite, si dhe mungesës së ndonjë lidhjeje mes transaksionit të huadhënies dhe burimit të tyre nga kursime të viteve deri në 2004, trupi gjykues krijoi bindjen se subjekti ka dështuar të provojë ekzistencën e një lidhjeje të arsyeshme dhe të logjikshme mes shumë s të dhënë hua dhe burimit të saj me gjendjen bankare të vitit 2004.

72. Në konkluzion, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë burimin e ligjshëm të të ardhurave sipas kërkesave të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, pasi nuk arriti të provojë se ato të ardhura ishin pikërisht të ardhurat e ndodhura në formë likuiditetesh bankare në llogari të prindërve të saj deri në vitin 2004 dhe, po ashtu nuk u provua se ato të ardhura (nëse do të pranoheshin si burim) kishin përmbushur në vetvete kërkesat e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe se për to ishin paguar detyrimet tatimore.

73. Trupi gjykues arrin në përfundimin se të ardhurat e pretenduara nga subjekti, përfituar prej prindërve nga shitja e pronave të tyre, nuk mund të përfshihen në analizën financiare lidhur me mundësinë e tyre për krijimin e vlerës 36.000 euro, dhënë hua subjektit të rivlerësimit.

Të ardhurat nga paga e subjektit dhe e bashkëshortit, përdorur si burim krijimi

74. Subjekti ka depozituar mandatarkëtimin nr. 175, datë 24.8.2016, të shoqërisë “****” sh.p.k., me përshkrimin “arkëtuar nga A.A., 2.000 euro, këst i fundit për apartamentin”.

75. Komisioni ka analizuar mundësinë financiare në momentin e pagesës së këstit të fundit të apartamentit në shumën 2.000 euro, në datën 24.8.2016.

Përshkrimi	Deri më 24.8.2016
Të ardhurat, datë 24.8.2016	1,349,190
Të ardhura nga paga e subjektit	691,430
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	427,414
Të ardhura nga paga e motrës	110,507
Të ardhura nga pensioni i babait	119,839
Detyrime, datë 24.8.2016	0
Shpenzime, datë 24.8.2016	1,585,044
Shpenzime jetike	940,368
Shpenzime mobilimi	0
Shpenzime udhëtimi	67,635
Këst kredie “Credins Bank”	203,105
Këst kredie “Raiffeisen Bank”	307,270
Shpenzime udhëtime pune	66,667
Pasuri, datë 24.8.2016	400,370
Kursime (shtesa/pakësime likuiditeti)	125,670

Pagesë kësti 2.000 euro, datë 24.8.2016	274,700
Të ardhura – shpenzime – pasuri	-636,224

76. Për sa më sipër, duket se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme për pagesën e këstit të fundit të apartamentit në shumën 2.000 euro, në datën 24.8.2016, pasi nga analiza financiare në momentin e pagesës kanë rezultuar me balancë negative në shumën 636.224 lekë.

77. Në lidhje me konstatimin e mësipërm të Komisionit, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të dhënë shpjegime, të shoqëruara me prova shkresore, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

78. Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e saj dhe gjatë seancës dëgjimore, ka dhënë shpjegimin se: *“Të gjitha të ardhurat janë administruar nga prindërit, duke rezultuar edhe në kursime, për vitet 2012, 2013 dhe 2014. Këto teprica në fund të viteve 2012, 2013 dhe 2014 nuk janë deklaruar si kursime nga ana ime, por as nuk janë shpenzuar, për shkak se jetesa ka qenë e përbashkët me familjen dhe të ardhurat kanë qenë të pandara, të cilat administroheshin nga prindërit. Kjo ka qenë edhe arsyeja të cilat nuk janë deklaruar si kursime në deklaratat respektive të pasurisë, për shkak se nuk janë disponuar fizikisht, por kanë qenë të bashkuara të gjitha të ardhurat bashkë. Familja ime nuk ka qenë subjekt deklarues dhe nuk kanë pasur detyrimin për deklarim”*.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

79. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në “Deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*”; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provave shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

80. Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk mund të merren në konsideratë, për sa kohë detyrimi i saj ligjor për të deklaruar pasuritë ka lindur që nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, përcaktimet e të cilit kanë qenë të qarta në këtë drejtim, lidhur me deklarimin e çdo pasurie të paluajtshme, të luajtshme, përfshirë edhe likuiditetet në formën *cash*, si dhe shtesat dhe ndryshimet në to.

81. Për rrjedhojë, çmon se marrja në konsideratë e këtij likuiditeti është një argument që nuk mbështetet në ligjin nr. 9043/2003, i ndryshuar, i cili ka parashikuar në mënyrë të qartë detyrimin e çdo subjekti rivlerësimi për të deklaruar çdo shtesë dhe pakësim të pasurisë në çdo formë që ajo ndodh përgjatë një viti periodik.

82. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit në prapësimet se është përdorur gjendja *cash*, por nuk është deklaruar, është qartësuar dhe konsoliduar nga vendimmarrjet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, ku, ndër të tjera, Komisioni orientohet se për zgjidhjen e çështjeve⁶ të ngjashme në

⁶ Vendimi (JR) nr. 7/2019 dhe vendimi nr. 11/2019, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Vendimi (JR) nr. 11/2019, i cili përcakton se: *“[...] Referuar nenit 4, pika 1, shkronja ‘d’ e të njëjtit ligj, në objektin e deklaratimit, sipas kësaj dispozite, përfshihet në konceptin e pasurisë së deklarueshme edhe vlera e likuiditeteve në gjendje cash, për të cilat, si për çdo pasuri tjetër, duhet të deklarohet gjendja deri më 31 dhjetor, në raport me deklarimin e mëparshëm mbi të njëjtën pasuri. [...] Gjithashtu, neni 7 i të njëjtit ligj përcakton në mënyrë të shprehur se në deklarimin periodik jepen vetëm ndryshimet e ndodhura në pasuritë, detyrimet financiare dhe interesat private të deklaruar më parë, sipas nenit 6 të këtij ligji. Në përputhje me përcaktimet e mësipërme ligjore, janë miratuar edhe modelet e formularëve të deklarimeve periodike, të cilat, në rubrikën e ndryshimeve të pasurive dhe interesave private, në shpjegimet orientuese për subjektet lidhur me mënyrën e deklarimit, udhëzojnë: Përshkruani hollësisht ndryshimet (shtesat, pakësimet) [...] të çdo lloj pasurie të paluajtshme dhe të luajtshme, likuiditete, të*

të ardhmen ... të mos prezumohet përdorimi nga subjektet i gjendjeve cash si burime për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, për sa kohë një gjë e tillë nuk është deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike [...].

82.1 Shpjegimi i subjektit se këto teprica në fund të viteve 2012, 2013 dhe 2014 nuk janë deklaruar si kursime, por as nuk janë shpenzuar, për shkak se jetesa ka qenë e përbashkët me familjen dhe të ardhurat kanë qenë të pandara, të cilat administroheshin nga prindërit, nuk mbështetet nga deklaratimet e babait të subjektit në deklaratën noteriale, ku ai nuk i përmend këto të ardhura si burime për huan e dhënë vajzës së tij.

83. Trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme për pagesën e kështit të fundit të apartamentit, në shumën 2.000 euro, në datën 24.8.2016.

84. Në përfundim, lidhur me apartamentin e banimit me sip. 80 m² dhe 9.7 m² sipërfaqe e përbashkët, ndodhur në Tiranë, trupi gjykues arrin në përfundimin se:

85. Deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratën *Vetting*, për apartamentin e banimit, duke mos deklaruar vlerën e saktë të huas së marrë nga prindërit e saj lidhur me vlerën si burim krijimi, e vendos atë në kushtet e deklaratimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “a”, të pikës 5, të nenit 33 dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

86. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk ka dorëzuar dokumentacion justifikues ligjor, lidhur me ligjshmërinë e burimit të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë së (i) hua nga prindërit në vlerën 36.000 euro, (ii) të ardhurat nga paga e subjektit dhe e bashkëshortit, trupi gjykues arrin në konkluzionin se kjo passjell mungesë të burimeve financiare të ligjshme për pagesën e kësaj pasurie.

87. Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë apartament banimi, në kuptim të parashikimeve të pikave 1, 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “b”, të pikës 5, të nenit 33 dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

2. Lidhur me automjetin tip “Daimler Chrysler”

88. Bashkëshorti i subjektit ka deklaruar automjet të markës “Daimler Chrysler” blerë sipas kontratës së shitblerjes të datës 21.12.2015. Burimi i krijimit i deklaruar: të ardhura në vlerën 2.000 euro të përfituara nga shitja e automjetit sipas kontratës së datës 22.6.2015. Vlera: 2.000 euro. Pjesa takuese: 50 %.

89. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015, bashkëshorti i subjekti ka deklaruar: *“Autoveturë e përdorur, me targa ***, vit prodhimi 2003, blerë sipas kontratës së shitblerjes me nr. ***, datë 21.12.2015. Burimi i krijimit: të ardhura të përfituara nga shitja e automjetit autoveturë, sipas kontratës nr. ***, datë 22.6.2015: të ardhura të përfituara nga shitja 2.000 euro”*.

90. Subjekti ka depozituar kontratën e shitblerjes të datës 21.12.2015⁷, me shitës E.B. dhe blerës A.A., për blerjen e automjetit tip “Daimler Chrysler”, në shumën 2.000 euro, likuiduar cash jashtë zyrës noteriale.

regjistruar ose jo në regjistrat publikë, për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit. [...]. [...] ‘25 Para miratimit të përmbajtjes aktuale të këtij neni, me miratimin e ligjit nr. 85/2012, ‘Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003’, ky detyrim ligjor përcaktohej shprehimisht në të njëjtën mënyrë nga neni 15, pika 7 e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, ‘Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike’. [...]’ Faqe 19 nga 20.

⁷ Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 21.12.2015.

Lidhur me burimin e krijimit

91. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015, bashkëshorti i subjektit deklaroi: *“Autoveturë ‘Daimler Chrysler’, viti 2002 blerë në datën 5.1.2015 me faturë shitje, shitës L.N. dhe blerës A.A. Burimi i krijimit: hua e marrë pa interes nga vjehri L.D., shuma prej 336.000 lekë e shlyer brenda vitit 2015”*.

92. Në faqen nr. *** të kësaj deklarate, personi i lidhur me subjektin/bashkëshorti ka deklaruar: *“Të ardhura nga shitja e automjetit ‘Daimler Chrysler’, viti 2002, sipas kontratës së shitblerjes nr. **, datë 22.6.2015, midis shitësit A.A. dhe blerësit D.A. në shumën 2.000 euro”*.

93. Në deklaratën *Vetting*, burimi i krijimit i deklaruar kanë qenë të ardhurat në vlerën 2.000 euro të përfituara nga shitja e automjetit, duke mos u deklaruar huaja e përdorur si burim krijimi.

94. Në pyetësin nr. 2, subjektit i është kërkuar të provojë me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të shumës 336.000 lekë të marrë hua për blerjen e automjetit dhe të japë shpjegime në lidhje me periudhën e shlyerjes së huas, si dhe burimin e ligjshëm të kthimit të saj.

94.1. Subjekti ka deklaruar se: *“Për sa i përket burimit të ligjshëm të shumës prej 100.000 lekë nga huadhënësi, vlejnë të njëjtat shpjegime sa më sipër dhe dokumentacion provues, për huan e dhënë për blerjen e apartamentit”*.

95. Subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të dhënë shpjegime, shoqëruar me prova shkresore, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë lidhur me sa vijon:

- i. subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë mungesë burimesh të ligjshme për blerjen e automjetit tip “Daimler Chrysler”, të vitit 2000, në datën 5.1.2015, në shumën 336.000 lekë, pasi nuk u provua burimi i ligjshëm i huas së dhënë në shumën 336.000 lekë, e cila ka shërbyer si burim krijimi për blerjen e këtij automjeti;
- ii. ka mospërputhje të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit me personin e lidhur/bashkëshorti, në lidhje me burimin e automjetit tip “Daimler Chrysler”, si vijon:
 - personi i lidhur me subjektin, bashkëshorti, ka deklaruar në DPV-në e vitit 2015, si burim krijimi, huan e marrë pa interes nga vjehri L.D., në shumën 336.000 lekë;
 - subjekti i rivlerësimit, në pyetësin nr. 2, deklaroi se shuma e dhënë hua nga babai L.D. ka qenë rreth 100.000 lekë, ndërsa pjesa tjetër prej 236.000 lekësh kanë qenë kursime të bashkëshortit A.A.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

96. Subjekti i rivlerësimit, në prapësime dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar se i qëndron shpjegimeve të dhëna në pyetësin nr. 2.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

97. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës dhe deklaratimet në seancat dëgjimore, arsyetoi se:

i) Lidhur me saktësinë e deklaratimit në deklaratën *Vetting*

98. Trupi gjykues vlerëson se sipas pikës 11, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, “pasuri” janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, që janë në pronësi, zotërim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit.

99. Formulari i deklarimit të pasurisë për rivlerësimin – shtojca 2 e ligjit nr. 84/2016 – vendos detyrimin e subjekteve të rivlerësimit për deklarimin e të gjitha pasurive të akumuluar, ndër vite, deri në ditën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, të ndodhura brenda dhe jashtë vendit, të cilat ndodhen në pronësi, në zotërim ose në përdorim nga subjekti i rivlerësimit apo në bashkëpronësi të tij me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose persona të tjerë të lidhur.

100. Në zbatim të legjislacionit të sipërcituar, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin që në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit të deklaronte pasuritë, si dhe burimet e krijimit të tyre. Bashkëshorti i subjektit nuk ka deklaruar burimin fillestar financiar, në kuptimin e të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie dhe as huan e përdorur si burim krijimi.

101. Për sa kohë, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të pasakta dhe kontradiktore, lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie Komisioni, referuar dhe vendimit nr. 11 (JR), datë 3.7.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, vlerëson se e ka të pamundur të dallojnë se cili deklarim është i vërtetë dhe cili ka qenë shkaku i vërtetë që e ka detyruar subjektin e rivlerësimit për të mos respektuar kërkesat urdhëruese të ligjit për të deklaruar saktësisht dhe plotësisht burimin e krijimit.

102. Trupi gjykues çmon të nënvizojë se përveç mungesës së koherencës në deklarime, mosdeklarimit të huas në deklaratën *Vetting* si burim krijimi, si dhe përpjekja e subjektit të rivlerësimit për të deformuar të vërtetën në funksion të paraqitjes të të dhënave, që lidheshin me justifikimin e burimeve të kësaj pasurie e vendosin subjektin në kushtet e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 3, të nenit 61, dhe nenit 33, pika 5, germa “a”, e ligjit nr. 84/2016.

ii) Lidhur me huan në vlerën në shumën 336.000 lekë, përdorur si burim krijimi

103. Trupi gjykues kreu një vlerësim të situatës faktike financiare të prindërve të subjektit në kohën e dhënies së huas, në raport me legjislacionin e zbatueshëm dhe në përputhje me parashikimet ligjore që rregullojnë këtë status, për të provuar ligjshmërinë e krijimit të vlerës monetare në shumën 336.000 lekë përdorur si burim krijimi i pasurisë, si një detyrim i parashikimeve ligjore.

103.1 Në vlerësim të faktit se si subjekti i rivlerësimit, ashtu edhe personat e tjerë të lidhur të deklaruar në cilësinë e huadhënësit ose huamarrësit, pasi kanë konfirmuar këtë marrëdhënie, referuar pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të këtyre pasurive, likuiditete të dhëna hua.

103.2. Pra, huadhënësit e vetëdeklaruar (prindërit e subjektit), së bashku me subjektin e rivlerësimit kishin detyrimin ligjor dhe kushtetues që gjatë procesit të rivlerësimit të justifikonin dhe të argumentonin me dokumente shoqëruese ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie, pjesë e çmimit të blerjes së automjetit nga bashkëshorti i subjektit.

103.3. Duke qenë se subjekti ka deklaruar se kjo hua ka të njëjtat burime me huan e marrë për apartamentin nga prindërit, trupi gjykues vlerëson se sipas të njëjtat arsyetim ligjor të përdorur lidhur me huan e marrë për blerjen e apartamentit, prindërit e subjektit nuk provojnë me burime të ligjshme mundësinë financiare për të dhënë hua shumën prej 336.000 lekësh, përdorur si burim krijimi i pasurisë.

103.4. Me dërgimin e prapësimeve, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm për blerjen e automjetit tip “Daimler Chrysler”, në vitin 2015, duke u ndodhur në kushtet e germës “b”, të pikës 5, të nenit 33 dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

104. Në përfundim, për automjetin tip “Daimler Chrysler” arrihet në përfundimin se:

- Nuk u deklarua në deklaratën *Vetting* burimi fillestar financiar që ka shërbyer për krijimin e kësaj pasurie, pasi nuk u deklarua hua e marrë nga prindërit e bashkëshortes, duke u kryer deklarim i pasaktë, në kundërshtim me parashikimet e germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, pasi bashkëshorti i saj në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin e krijimit të këtij automjeti në pronësi të tij.

- Për sa kohë subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të pasakta dhe kontradiktore lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, Komisioni, referuar edhe vendimit nr. 11 (JR), datë 3.7.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, vlerëson se e ka të pamundur të dallojë se cili deklarim është i vërtetë dhe cili ka qenë shkaku i vërtetë që e ka detyruar subjektin e rivlerësimit të mos respektojë kërkesat urdhëruese të ligjit për të deklaruar saktësisht dhe plotësisht burimin e krijimit.

- Trupi gjykues çmon të nënvizojë se përveç mungesës së koherencës në deklarime, mosdeklarimit të huas në deklaratën *Vetting* si burim krijimi, si dhe përpjekja e subjektit të rivlerësimit për të deformuar të vërtetën në funksion të paraqitjes së të dhënave, lidhur me pasurinë e luajtshme automjet tip “Daimler Chrysler”, që lidheshin me justifikimin e burimeve të kësaj pasurie e vendosin subjektin në kushtet e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 3, të nenit 61, si dhe germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

3. Gjendja e llogarisë rrjedhëse në “Credins Bank”

105. “Credins Bank” konfirmon llogarinë rrjedhëse të pagës në emër të subjektit të rivlerësimit, në datën 24.1.2017, në shumën 556.01 lekë. Në këtë llogari, duke filluar nga viti 2012, subjekti përfiton pagat nga puna e saj si gjyqtare, si dhe është disbursuar kredia në vlerën prej 7.000.000 lekësh, për të cilën kryhen pagesat e kësteve për shlyerjen e saj. Nuk u konstatuan problematika lidhur me deklarimin e kësaj llogarie.

4. Kursime cash në shumën 150.000 lekë

106. Kursime *cash* të subjektit në vlerën 150.000 lekë me pjesë takuese: 50%. Burimi i krijimit: të ardhura nga paga personale dhe e bashkëshortit.

107. Subjekti i rivlerësimit, në DIPP-në e vitit 2015, ka deklaruar: “*Kursime cash në vlerën 200.000 lekë. Burimi i krijimit: të ardhura nga paga personale dhe e bashkëshortit*”.

108. Në deklarimin vjetor të vitit 2016, subjekti ka deklaruar: “*Pakësim i kursimeve cash të deklaruar në vitin 2015. Burimi i krijimit: të ardhura nga paga personale dhe e bashkëshortit. Kjo shumë është përdorur për të shlyer pjesën e mbetur të kredisë sipas kontratës, datë 18.1.2012, të bashkëshortit A.A. Kursime cash në vlerën 150.000 lekë. Burimi i krijimit: të ardhura nga paga personale dhe e bashkëshortit për vitin 2016*”.

109. Nuk u konstatuan problematika lidhur me deklarimin e subjektit në lidhje me gjendjen *cash* të deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe në deklaratat periodike vjetore.

DEKLARIMI I PERSONIT TË LIDHUR/BASHKËSHORTI I SUBJEKTIT

1. Tokë arë me sip. 10.000 m² në V., Shkodër

110. Fituar në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, bashkëpronar në ¼ pjesë sipas certifikatës së përbërjes familjare kanë qenë 4 anëtarë, për këtë arsye pjesa zotëruese është ¼. Burimi i krijimit: ligji nr. 7501, “Për tokën”.

111. Subjekti i rivlerësimit ka depozituar certifikatën e pronësisë datë 14.4.2014 për pasurinë e llojit tokë “arë” me sip. 10.000 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, Shkodër, në emër të znj. R.A. (nëna e bashkëshortit të subjektit).

112. Në përgjigjen e administruar nga dosja e ILDKPKI-së, përcjellë Komisionit, rezulton se nga ZVRPP-ja Shkodër është dërguar dokumentacioni ligjor, tri certifikata pronësie si vijon:

- certifikatë pronësie e datës 14.4.2014, në emër të znj. R.A. për pasurinë e llojit “arë” me sip. 16.000 m², në V., Shkodër me shënimin “mbyllur”;
- certifikatë pronësie e datës 14.4.2014, në emër të znj. R.A. për pasurinë e llojit “arë” me sip. 6.000 m², në V., Shkodër;
- certifikatë pronësie e datës 14.4.2014, në emër të znj. R.A. për pasurinë e llojit “arë” me sip. 10.000 m², në V., Shkodër.

113. Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se ka mospërputhje deklarimi i personit të lidhur/bashkëshorti A.A. me dokumentacionin ligjor për pasuritë në emër të nënës së tij, ku është bashkëpronar me pjesë takuese ¼ si anëtar i familjes bujqësore si vijon:

i) personi i lidhur me subjektin, bashkëshorti A.A., në deklaratën *Vetting* ka deklaruar pasurinë e llojit “arë” me sip. 10.000 m²;

ii) ZVRPP-ja Shkodër konfirmon pasuritë e llojit “arë” me sip. 10.000 m² dhe 6.000 m², në emër të znj. R.A. (sipas certifikatave për vërtetim pronësie, ku ajo me sip. 16.000 m² rezulton të jetë e mbyllur ndërsa dy të tjerat, përkatësisht me sip. 10.000 m² dhe 6.000 m² janë aktive).

114. Gjithashtu u konstatua mungesë dokumentacioni ligjor për mënyrën e përfitimit të këtyre pasurive të regjistrua në emër të znj. R.A., nëna e z. A.A.

115. Për konstatimet e mësipërme, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës që të japë shpjegime shoqëruar me dokumente shkresore, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

116. Subjekti, në prapësimet e saj dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar se si subjekt rivlerësimi nuk gëzon asnjë të drejtë pronësie apo përdorimi, pasi është një pasuri e përfiturar nga familja e bashkëshortit A.A., në bazë të ligjit nr. 7501, “Për tokën”.

116.1. Pasuria është përfiturar me AMTP, ku e gjithë sipërfaqja ka qenë 16.000 m² për të gjithë familjen bujqësore, sipas kontratës së shitblerjes së datës 18.4.2014.

116.2 Rezulton se palët shitëse R., I., D. dhe A.A. (të gjithë bashkëpronarë), të përfaqësuar nga znj. R.A., në bazë të prokurës së posaçme datë 19.2.2014, i kanë shitur një pjesë nga pasuria sa më sipër, tokë arë me sip. 6.000 m², në V., Sh., palës blerëse F.L. kundrejt shumës 1.758.000 lekë, shumë deklaruar e likuiduar midis palëve jashtë zyrës noteriale.

117. Subjekti ka shpjeguar se nga kjo shumë bashkëshorti ende nuk e ka përfiturar pjesën e tij takuese, prandaj nuk e ka deklaruar si të ardhur, por është një detyrim që nuk është përmbushur ndaj bashkëshortit nga nëna e tij, e cila ka vepruar si përfaqësuese në bazë të prokurës së posaçme. Në momentin që do të përfitohet kjo e ardhur sipas pjesës takuese do të deklarohet sipas ligjit.

118. Subjekti shpjegon se kjo pasuri është përfiturar nga AMTP-ja, pasqyruar kjo edhe në kartelën e pasurisë së kësaj prone.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

119. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancat dëgjimore arsyeton se:

- Sipas pikës 11, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, “pasuri” janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, “Për deklarinin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit.

- Sipas pikës 1, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklaratimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur.

- Formulari i deklaratimit të pasurisë për rivlerësimin – shtojca 2 e ligjit nr. 84/2016 – vendos detyrimin e subjekteve të rivlerësimit për deklarinin e të gjitha pasurive të akumuluar ndërsa vite, deri në ditën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, të ndodhura brenda dhe jashtë vendit, të cilat ndodhen në pronësi, në posedim ose në përdorim nga subjekti i rivlerësimit apo në bashkëpronësi të tij me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose persona të tjerë të lidhur.

120. Trupi gjykues vlerëson se në deklaratën *Vetting* nuk është deklaruar nga bashkëshorti A.A., në cilësinë e bashkëpronarit, tjetërsimi i pjesës takuese të tij dhe përfitimi prej tij i vlerës prej 439.500 lekësh.

121. Si në çdo marrëdhënie juridiko-civile, palët kanë pasur lirinë të negociojnë lidhur me të gjitha kushte e kontratës, ndër to edhe për përfitim nga çdo pronar i tokës arë me sip. 6.000 m², në V., Shkodër. Përpos gjithë sa më sipër, edhe nëse ky detyrim që nuk është përmbushur ndaj bashkëshortit nga nëna e tij, e cila ka vepruar si përfaqësuese në bazë të prokurës së posaçme, kjo rrethanë nuk ka se si të ndikojë rezultatin e arritur se personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit dhe subjekti kanë kryer deklarinin të pasaktë lidhur me këtë pasuri.

122. Për këtë arsye, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të/bashkëshortin, kanë kryer deklarinin të pasaktë, në kundërshtim me parashikimet e germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

2. Gjendja e llogarisë rrjedhëse në “Credins Bank”

123. “Credins Bank”⁸ konfirmon llogarinë rrjedhëse të pagës në emër të subjektit të rivlerësimit në datën 24.1.2017, në shumën 227.06 lekë.

Konkluzion për rivlerësimin e pasurisë

124. Për pasurinë apartament me sip. 80 m², në Tiranë, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka pasaktësi në deklaratën e pasurisë *Vetting* lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie dhe mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, sipas parashikimeve në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe germave “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33 dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

⁸“Credins Bank” me shkresën nr. *** prot., datë 4.2.2020.

125. Për pasurinë automjet tip “Daimler Chrysler”, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka pasaktësi në deklaratën e pasurisë *Vetting* lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie në kuptim të parashikimeve të pikave 1, 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe germave “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33 dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

126. Për pasurinë tokë arë me sip. 10.000 m² në V., Shkodër, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë kryer deklaram të pasaktë, në kundërshtim me parashikimet e germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, pasi në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit nuk kanë deklaruar saktësisht këtë pasuri.

127. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se bazuar në konkluzionet e arritura më lart në konsideratë edhe të standardeve të vendosura nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, subjekti i rivlerësimit znj. Luveda Dardha nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

B. KONTROLLI I FIGURËS

128. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka dërguar në Komision, me shkresën nr. *** prot., datë 9.4.2021, raportin mbi kontrollin e figurës nr. *** prot., datë 18.3.2021, për subjektin e rivlerësimit Luveda Dardha, i deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. ***, datë 9.4.2021, të KDZH-së dhe nga Grupi i Punës është konkluduar se në vijim të informacioneve të ardhura nga institucioni i verifikimit, në kohështrirje gjatë periudhës së rivlerësimit për përfshirje në korrupsion pasiv të subjektit të rivlerësimit Luveda Dardha rezulton se:

- i) gjatë periudhës në të cilën znj. Luveda Dardha ushtronte detyrën si gjyqtare dyshohet se është përfshirë në veprime korruptive;
- ii) për subjektin Luveda Dardha, në cilësinë e gjyqtares, ngrihen dyshime se ka ushtruar ndikim të paligjshëm në disa procese penale;
- iii) institucionet verifikuese kanë informuar mbi dyshime për veprimtari të kundërligjshme në sistemin e drejtësisë.

129. Në vlerësim të të dhënave që disponohen nga autoritetet verifikuese për subjektin e rivlerësimit Luveda Dardha, arsyetohet të merren parasysh elementët që evidentojnë përfshirjen e saj në veprimtari korruptive, pasi në frymën e ligjit nr. 84/2016 vlerësohet se integriteti profesional është përcaktues për pastërtinë e figurës së subjekteve të rivlerësimit dhe sa më sipër:

- a) Situata pasqyron korrupsion sistematik në vetë sistemin e drejtësisë ku në rastin në fjalë përfshihet në veprime korruptive një gjyqtare. Kjo veprimtari e paligjshme i përmbahet përcaktimit të pikës 8, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, ku përfshihen veprat penale të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale “krimi i organizuar, trafikimi dhe korrupsioni”.
- b) Informacionet që disponohen në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, për implikim në veprimtari korruptive të funksionarit të drejtësisë, për të kryer ose moskryer një veprim që lidhet me detyrën e tij funksionale sipas kërkesave të germave “b” dhe “c”, të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016 e bën subjektin e rivlerësimit individ që mund të vihet nën presion nga strukturat kriminale.
- c) Në këndvështrimin e përgjithshëm të kontrollit të pastërtisë së figurës së një subjekti rivlerësimi, në këtë rast, në cilësinë e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, çdo dyshim i arsyeshëm për kryerje ose moskryerje të veprimeve në kundërshtim me ligjin në mospërmbushje të rregullt të detyrës dhe kur këto veprime apo mosveprime sjellin përfitime materiale ose jomateriale të padrejta për atë vetë si funksionar publik, apo për persona të lidhur me të, duke dëmtuar interesat e ligjshme të shtetit apo personave të tjerë,

vlerësohet se cenohet pastërtia e figurës së subjektit në fjalë dhe shkalla e besueshmërisë së saj.

130. Në përfundim, Grupi i Punës, nisur nga të dhënat e siguruar nga autoritetet verifikuese, ndryshon konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit, nga përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës në papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit Luveda Dardha.

131. Komisioni, nga informacioni i dhënë në raportin e DSIK-së, në përputhje me paragrafin 4, të nenit 41, të ligjit nr. 84/2016, e shtriu hetimin administrativ duke kërkuar informacion në lidhje me çështje gjyqësore të shtetasve S.F. dhe P.F.

132. Në lidhje me shtetasin S.F., Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka përcjellë 4 vendime gjyqësore të njehsuara me origjinalin⁹, të cilët janë gjykuar nga gjyqtarë të tjerë dhe jo nga subjekti i rivlerësimit Luveda Dardha.

133. Në lidhje me shtetasin P.F. gjykata ka përcjellë vendimin gjyqësor nr. ***, datë 17.6.2020, të dhënë nga subjekti Luveda Dardha.

Ky vendim i referohet të pandehurit P.F., i akuzuar për veprën penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve”, të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal.

134. Prokuroria, në këtë çështje, kërkoi: *“Deklarimin fajtor të të pandehurit P.F. për kryerjen e veprës penale ‘prodhim dhe shitje e narkotikëve’ dhe në bazë të nenit 283/1 të Kodit Penal dënimin e tij me 7 vjet burgim. Sugjerojmë gjykatën që në masën e dënimit të aplikojë kërkesat e nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, duke ulur dënimin me 1/3 dhe dënimin e tij me 4 vjet e 8 muaj burgim [...]. Provat materiale cannabis attiva në peshën 60 kg ... të asgjësohen etj.”.*

135. Gjykata, me vendimin e dhënë prej saj, ka vendosur: *“Deklarimin fajtor të të pandehurit P.F. për kryerjen e veprës penale ‘prodhim dhe shitje e narkotikëve’ dhe në bazë të nenit 283/1 të Kodit Penal dënimin e tij me 6 vjet burgim. Në zbatim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale i ulet dënimi me 1/3 dhe i pandehur P.F. dënohet përfundimisht me 4 vjet burgim. Në bazë të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim për pjesën e pavuajtur të dënimit duke e vendosur në provë të pandehurin për një periudhë 5-vjeçare me kusht që gjatë kësaj periudhe të mbajë kontakt me zyrën e provës. Provat materiale cannabis attiva në peshën 60 kg të asgjësohen [...]. Konstatohet shuarja e masës së sigurimit personal ‘arrest në burg’. Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i të pandehurit P.F. nga dhomat e paraburgimit”.*

136. Gjykata, në vendim ka arsyetuar se në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim, ka mbajtur parasysh: (a) rrezikshmërinë e autorit, ku gjatë gjykimit nuk rezultoi se i pandehuri të jetë dënuar më parë për kryerjen e ndonjë vepre penale; (b) nga gjykata vlerësohet se i pandehuri ka përgjegjësi thelbësore familjare pasi ka 5 fëmijë, 4 të mitur dhe kanë të domosdoshme përkujdesjen e tij, fakt ky i provuar nga certifikata familjare; (c) gjithashtu gjendja e vështirë, pasi edhe bashkëshortja e tij është e papunë dhe merr familjarisht ndihmë ekonomike në masën 7.920 lekë/muaj, vërtetuar nga Bashkia e Vaut të Dejës; (ç) gjithashtu, në cilësinë e kryefamiljarit do të ketë mundësi të punësohet pranë subjektit “V.P.”, me objekt bar-kafe, i cili merr përsipër punësimin e tij, provuar ky fakt me deklaratë noteriale.

⁹Vendimi nr. ***, datë 10.2.2016, gjykuar nga gjyqtarja A. Ll.; vendimi nr. ***, datë 12.5.2016, gjykuar nga gjyqtarja A. Ll.; vendimi nr. ***, datë 17.6.2016, gjykuar nga gjyqtarja A. Ll.; vendimi nr. ***, datë 7.3.2019, gjykuar nga gjyqtarët S. SH., A. Ç. dhe E. D.

137. Prokurori, ndaj vendimit të gjykatës, ka bërë ankim pranë Gjykatës së Apelit Shkodër. Komisioni ka administruar nga Gjykata e Apelit Shkodër¹⁰ ankimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër kundër vendimit me nr. ***, datë 17.6.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

138. Komisioni, nga analizimi i dokumentacionit në dosje, ka konstatuar se në rastin konkret nuk përmbushen kriteret e nenit 59 të Kodit Penal për pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënien në provë për arsye se:

i) Vepra penale për të cilën është vendosur pezullimi i ekzekutimit të dënimit “prodhim dhe shitje e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal është një vepër e përhapur dhe që paraqet rrezikshmëri shoqërore, e shprehur kjo edhe në marzhin e dënimit që parashikon duke e dënuar të pandehurin vetëm me burgim nga 5 vjet deri në 10 vjet.

ii) Personi që kryen këtë vepër penale, gjithashtu, paraqet rrezikshmëri shoqërore duke pasur parasysh faktin që i pandehuri nuk e ka pranuar akuzën si gjatë hetimeve edhe në gjykimin e çështjes, duke mos treguar qëndrim pendues për veprën e kryer dhe sjelljen pas kryerjes së veprës penale. Edhe pse personi ka personalitet si i padënuar më parë, kjo nuk mund të aplikohet si rrethanë në rastin konkret në drejtim të rrezikshmërisë së personit, sepse vepra penale kryhet në shkallën më të lartë të fajit, me dashje direkte dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale, mënyra dhe koha, roli i personit, pasoja (pra, sasia) i japin rëndësi faktit dhe nuk tregojnë rrezikshmëri të pakët të veprës dhe autorit.

iii) Nga gjykimi i çështjes nuk rezultuan rrethanat që justifikojnë pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim si ato që lidhen me moshën, pasi moshë e të pandehurit është e re, nuk u vërtetuan kushtet shëndetësore apo mendore të tilla për pamundësinë e vuajtjes së dënimit. Në rastin konkret, nevojat familjare mund të përmbushen nga anëtarët e familjes edhe pse i pandehuri ka fëmijë të mitur.

139. Për konstatimet e mësipërme subjektit të rivlerësimit iu kërkuan shpjegime bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016 dhe në Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

140. Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e saj dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar se: *“Së pari vlerësoj se çështja sa më sipër është ende në gjykim dhe vendimi nuk ka marrë formë të prerë. Në rastin konkret, duke u nisur nga tërësia e rrethanave të kryerjes së veprës penale, rrezikshmërisë shoqërore, rrezikshmërisë së autorit, rrethanave rënduese dhe lehtësuese, vlerësoj se ka qenë rasti për të aplikuar dënimin alternativ, sipas nenit 59 të Kodit Penal. Ky nen parashikon se: me titull ‘Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë’ përcakton se: ‘Për shkak të rrezikshmërisë së pakët të personit, moshës, kushteve shëndetësore apo mendore, mënyrës së jetesës dhe nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanave të kryerjes së veprës penale, si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale, gjykata kur jep dënim me burg gjer në pesë vjet, mund të urdhërojë që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të vihet në provë duke pezulluar ekzekutimin e dënimit, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale. 3. Për dënimet e dhëna deri në dy vjet burgim, të pezulluara nga gjykata, afati i provës është sa dyfishi i kohës së dënimit me burgim të dhënë nga gjykata. 4. Afati i provës, me përjashtim të rregullit të parashikuar në paragrafin 3 të këtij neni, është 24 muaj deri në 5 vjet. Afati i provës fillon nga e nesërmja e shpalljes së vendimit të gjykatës që ka dhënë vendimin për pezullimin e dënimit*

¹⁰Shkresa me nr. *** prot., datë 5.3.2021, e Gjykatës së Apelit Shkodër, e cila ka dërguar ankimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

me burgim'. Duke u nisur nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se në mënyrë që të aplikohet neni 59 i Kodit Penal, duhet të përmbushen kushtet si më poshtë:

Së pari, dhënia e një vendimi dënimi deri në 5 vjet, ku në rastin konkret ky kusht është plotësuar, pasi ndaj të pandehurit është dhënë një dënim me 6 vjet burgim, ku pas aplikimit të gjykimit të shkurtuar dënimi përfundimtar ndaj tij ka qenë 4 vjet burgim.

Së dyti, rrethanat e përcaktuara në përmbajtjen e nenit 59 të Kodit Penal nuk kërkohet domosdoshmërisht të ekzistojnë të gjitha njëkohësisht në mënyrë kumulative, por mjafton që të ekzistojë një ose disa prej tyre.

Rrezikshmëria e pakët e personit, e cila përcaktohet kryesisht nga fakti nëse ka qenë ose jo i dënuar më parë, ku në rastin konkret nuk rezultoi që i pandehuri të ishte i dënuar më parë. Fakti që e pranon ose jo akuzën nuk e bën personin më pak ose më shumë të rrezikshëm, por kjo është një rrethanë që mbahet parasysht në caktimin e masës së dënimit nga gjykata. Pasi ky është një vendim fajësie, i cili nuk ka marrë formë të prerë, në kushtet kur i pandehuri mund të pretendojë edhe pafajësi në gjykimin në apel.

Mosha apo kushtet shëndetësore, ku në rast se i pandehuri ka një moshë relativisht të madhe, por edhe relativisht të re, kjo është një rrethanë që vlerësohet në raport me rrethanat të tjera, të cilat rezultojnë të provuara në gjykim, sikurse mund të jetë, ndjekja e një arsimit apo formimi profesional, mundësia e një punësimi, apo edhe kushte shëndetësore të vështira, të cilat mund të ekzistojnë si në rastin e një të pandehuri me moshë të re, por edhe me moshë të madhe.

Mënyrës së jetesës dhe nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin, ose punën, rrethanave të kryerjes së veprës penale. Ky rast i referohet faktit kur i pandehuri ka një mënyrë jetese të tillë që imponon detyrime thelbësore familjare, sikurse është rasti i përkujdesjes dhe mirërritjes për fëmijë të mitur, ku në rastin konkret i pandehuri ka pasur jo një, por 5 fëmijë të mitur, nën moshën 18 vjeç, fakt i provuar në gjykim nëpërmjet certifikatës së përbërjes familjare. Nga ana tjetër rezultuan rrethanat të tjera familjare, të cilat provonin pamundësinë ekonomike të familjes, në rastin konkret nënës së fëmijëve për të përballuar e vetme rritjen dhe kujdesin ndaj tyre. Pasi dhe gjendja ekonomike e të pandehurit rezultoi të paraqitej e vështirë, në kushtet kur edhe bashkëshortja e tij ishte e papunë dhe merrte familjarisht ndihmë ekonomike në masën 7.920 lekë/muaj, me nr. dosje ***. Ky fakt u provua në gjykim nëpërmjet vërtetimit nr. *** prot., datë 12.6.2020, lëshuar nga Bashkia Vau i Dejës, sektori i ndihmës ekonomike.

Nevoja për punësim, duke u nisur nga rrethanat sa më sipër, përgjegjësia familjare për kujdesin dhe rritjen e 5 fëmijëve të mitur, situata e vështirë ekonomike e familjes dhe ekzistenca e një mundësie për punësim nga ana e të pandehurit, për të kontribuar, në përmirësimin dhe stabilitetin ekonomik të familjes së tij, janë rrethanat të cilat gjykata ka detyrimin t'i vlerësojë në aplikimin e një prej alternativave të dënimit. Mundësia për t'u punësuar e të pandehurit, u provua në gjykim nëpërmjet subjektit V. P., me objekt aktiviteti 'bar – kafe', i cili merrte përsipër punësimin e tij. Ky fakt u provua nëpërmjet deklaratës noteriale me nr. ***, datë 17.6.2020.

Mungesa e rrethanave cilësuese të bashkëpunimit apo më shumë se një herë, pasi rezultoi se vepra u cilësua sipas nenit 283/1 të Kodit Penal, e cila paraqet marzhe më të ulëta dënimi si në minimum ashtu edhe në maksimum.

Sipas standardeve ndërkombëtare, përdorimi i burgimit si formë dënimi duhet kufizuar rreptësisht dhe të jetë një extrema ratio në raste të veçanta, atëherë kur nuk mund të zbatohen masa të tjera të përshtatshme. Siç shprehet Këshilli i Evropës, burgimi duhet të zbatohet si masë vetëm 'kur çdo masë apo sanksion tjetër do të ishin të papërshtatshme për rëndësinë e

veprës', dhe duhen bërë përpjekje që të minimizohet përdorimi i masave që e privojnë personin nga liria dhe të zbatohen më shumë të cilat nuk e bëjnë këtë'.

Duke vlerësuar kohën relativisht të gjatë të qëndrimit në paraburgim të të pandehurit, prej rreth një viti, në kushtet kur qëllimi i dënimit nuk është vetëm ndëshkimi i personit, por edhe rehabilitimi i tij, vendosja e tij nën mbikëqyrjen e shërbimit të provës për pjesën e pavuajtur të dënimit, për një afat maksimal 5 vjet, përmbush qëllimet e dënimit. Në çdo rast, eventualisht të mospërmbushjes së detyrimeve gjatë kohës së provës, të pandehurit, mund t'i revokohet kjo mënyrë dënimi dhe pjesa e pavuajtur mund të vuhet në burgim.

Sasia e lëndës narkotike, pavarësisht se në rastin konkret ka qenë relativisht e madhe, nuk është përcaktuese në përcaktimin e një personi si të rrezikshëm ose jo, por kjo është një rrethanë, e cila nuk duhet vlerësuar e ndarë nga rrethanat e tjera, të analizuara më sipër. Në aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal është vendosur një praktikë dhe standard nga gjykata, që në rast të ekzistencës së një apo disa rrethanave të parashikuara në nenin 59 të Kodit Penal, kjo alternativë duhet të gjejë zbatim, me përjashtim të veprave penale, të cilat për nga objekti që cenojnë, sikurse jeta, shëndeti, liria personale dhe vepra të tjera të kësaj natyre, kjo alternativë dënimi nuk zbatohet për shkak të rrezikshmërisë së lartë të këtyre veprave penale, duke u nisur nga objekti që synojnë të mbrojnë.

Theksoj se përtej arsyeve të parashtruara, ky dënim alternativ është zbatuar edhe në kushtet e pandemisë Covid-19, ku nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, nëpërmjet një rekomandimi të dërguar nga Ministria e Drejtësisë, drejtuar të gjitha gjykatave në Republikën e Shqipërisë, u rekomandua të zbatoheshin për aq sa ishte e mundur masat shtrënguese, të ndryshme nga ajo e 'arrestit në burg', si dhe aplikimin më të shpeshtë të dënimeve alternative, me qëllim për të parandaluar rritjen e numrit të personave që vuajnë dënimin në institucionet e vuajtjes së dënimit, si dhe për mbrojtjen e jetesës dhe shëndetit të tyre. Kjo letër gjendet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.

Për të gjitha argumentet e parashtruara sa më sipër, vlerësoj se është respektuar ligji penal material, veçanërisht të gjitha kriteret, të parashikuara në përmbajtjen e nenit 59 të Kodit Penal.

Gjithashtu, gjykata, në caktimin e dënimit, është e detyruar të bazohet edhe në parimet e nenit 1/c të Kodit Penal, me titull 'Parimet e Kodit Penal', ku parashikohet se: 'Kodi Penal bazohet në parimet kushtetuese të shtetit të së drejtës së barazisë përpara ligjit, të drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe të dënimit, të mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijëve dhe të humanizmit'.

Në mungesë të këtyre rrethanave, të analizuara sa më sipër, alternativa e dënimit sipas nenit 59 të Kodit Penal, nuk do të ishte zbatuar nga gjykata".

141. Trupi gjykues çmon se:

- Vepra penale "prodhim dhe shitje e narkotikëve", parashikuar nga neni 381/1 i Kodit Penal, parashikon një masë dënimi me burgim nga 5 deri në 10 vjet dhe nga Prokuroria është kërkuar 7 vjet burgim, duke pasur parasysh faktin se i pandehuri ka transportuar një sasi lënde narkotike prej 60 kg, ndërkohë, Gjkata, në përfundim, e ka vënë të pandehurin në periudhë prove me kusht të mos kryejë veprë tjetër penale.

- Aplikimi i nenit 59 të Kodit Penal, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit me burgim për pjesën e pavuajtur të dënimit në rastin konkret, është zbatuar nga gjykata pa marrë parasysh kriteret specifike që parashikon legjislacioni në këto raste.

- Rrethanat për të cilat kjo dispozitë parashikon mundësinë e pezullimit të ekzekutimit të dënimit dhe vënien në provë të të dënuarit janë:

Rrezikshmëria e pakët e personit – kjo rrethanë, në mënyrë kategorike, nuk rezulton në rastin konkret. Nuk mund të quhet person me rrezikshmëri të pakët kur ky shtetas ka organizuar gjithçka që nga marrja e automjetit që i përkiste një shtetasi tjetër, paketimin e lëndës narkotike, transportimin e saj me këtë automjet, fshehjen e saj në një vend në pyll që të mos dukej dhe nuk mund të barazohet rrezikshmëria e këtij të pandehuri me rrezikshmërinë e një përdoruesi lëndësh narkotike, të cilit i është gjetur një sasi disa gramë lëndësh narkotike dhe që megjithatë gjykata ka pasur raste dhe i ka dënuar me burgim pa i pezulluar ekzekutimin e dënimit me burgim.

Mosha e personit, kushtet shëndetësore dhe mendore – ky grup rrethanash sërish nuk mund të konsiderohet si rrethanë favorizuese në rastin konkret, pasi i pandehuri është i moshës 39-vjeçare me gjendje shumë të mirë shëndetësore dhe mendore, i përgjegjshëm për veprimet e kryera. Përkundrazi, mosha e tij dëshmon për një rrezikshmëri të shtuar të këtij rasti kur një person, megjithëse në një moshë të tillë, ka guximin dhe ndërmerr veprime për të cilat legjislatori e ka parashikuar si vepër penale dhe parashikon një dënim me burgim nga 5 deri 10 vjet, tregon se pezullimi i ekzekutimit të dënimit nuk sjell tjetër veçse efekt të kundërt tek i pandehuri duke bërë që dënimi i tij të mos ketë asnjë lloj efekti parandalues në asnjë kuptim që mbart në vetvete ky nocion.

Mënyra e jetesës dhe nevojat e veçanta, veçanërisht ato që lidhen me familjen, shkollimin ose punën – këto rrethana nuk rezultojnë të pranishme në rastin konkret, pasi i pandehuri ka përfunduar arsimin që ka dashur të marrë dhe nuk ka ndjekur ndonjë proces mësimor, kurs privat etj. Në lidhje me familjen është kryefamiljar, por sasia e lëndës narkotike është e konsiderueshme dhe nuk mund të përfitojnë nga neni 59 i Kodit Penal të gjithë personat që janë kryefamiljarë.

Sjellja pas kryerjes së veprës penale – kjo rrethanë e cila është e lidhur ngushtë edhe me rrethanat e kryerjes së veprës penale nuk ka qenë e tillë që të ndikojë në aplikimin e pezullimit të dënimit, pasi i pandehuri nuk e ka pranuar akuzën gjatë hetimit paraprak, si dhe gjatë gjykimit duke mos shprehur pendim për veprën penale. I pandehuri nuk ka bashkëpunuar që në momentin e parë me policinë duke i gënjyer ata, nuk ka pranuar akuzën dhe nuk ka bashkëpunuar me prokurorinë si gjatë hetimeve paraprake edhe gjatë gjykimit.

Gjykata duhej të vlerësonte fenomenin kriminal shumë shqetësues të kësaj vepre që ka tendencë në rritje në rrethin e Shkodrës – në kushtet kur aplikohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim, por jo në rastin konkret, pasi në këtë mënyrë jepet mesazhi i keq se si përdorues i lëndës narkotike që arrestohet për sasi të vogla lënde narkotike ashtu edhe ai që arrestohet për një sasi 60 kg lëndë narkotike kanë të njëjtën rrezikshmëri të ulët shoqërore dhe përjashtohen nga dënimi me burgim për pjesën e pavuajtur, pasi iu pezullohet ekzekutimi i dënimit me burgim duke inkurajuar kështu kontigjentin e kriminit të kësaj vepre penale.

142. Në vlerësim të trupit gjykues mbahet dhe sa ka rezultuar nga aksesit nga ana e trupit gjykues të Komisionit, së bashku me vëzhguesin ndërkombëtar të ONM-së, në informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, që i përket praktikës së verifikimit të kryer nga Shërbimi Informativ Shtetëror për kontrollin e kriterit të figurës, për subjektin e rivlerësimit me qëllim verifikimin e burimeve të informacionit që kanë shërbyer për arritjen e konkluzioneve të paraqitura nga Grupi i Punës në raportin e DSIK-së.

142.1 Aksesimi i informacioneve të klasifikuara “sekret shtetëror” u krye në mënyrë të drejtpërdrejtë duke u vënë në dispozicion të trupit gjykues të Komisionit dhe vëzhguesit ndërkombëtar të ONM-së, dosja që i përket praktikës së verifikimit të kryer nga SHISH-i për kriterin e kontrollit të figurës së subjektit të rivlerësimit.

142.2 Në kuadër të standardit të vendosur nga jurisprudenca e GjEDNj-së në çështjen Regner kundër Republikës Çeke, njohja me provat e administruara gjatë hetimit të Komisionit, për shkak të natyrës së informacionit që mbart edhe kushtet specifike të ruajtjes, administrimit dhe përdorimit të tij, u krye pranë ambienteve të autoritetit kompetent shtetëror, trupi gjykues verifikoi në vend të njëjtin informacion të aksesuar edhe nga Grupi i Punës së DSIK-së, si dhe burimet e informacionit që kanë shërbyer për hartimin e raportit të Grupit të Punës pranë DSIK-së.

142.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në drejtim të verifikimeve të rezultateve të raportit të DSIK-së, rezultatet e hetimit të Komisionit në tërësinë e tyre mbështesin nxjerrjen e përfundimit nga Grupi i Punës së DSIK-së, lidhur me papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit Luveda Dardha për vijimin e detyrës.

Konkluzioni për kontrollin e figurës

143. Komisioni, pas hetimit të kryer për këtë kriter, bazuar në nenin DH të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në vlerësim të raportit të DSIK-së, rezultateve të hetimit lidhur me çështjen e referuar më lart dhe në kuadër të çmuarjes së shpjegimeve që ka dhënë edhe subjekti, krijoi bindjen se informacionet që disponoheshin në ngarkim të subjektit të rivlerësimit Luveda Dardha sipas kërkesave të germave “b” dhe “c”, të nenit 37, të ligjit nr. 84/2016, ishte i bazuar në fakte dhe rrethana konkrete.

144. Në këndvështrimin e përgjithshëm edhe nëse ky konkluzion nuk do të ishte i mjaftueshëm për të arritur në një konkluzion lidhur me kontrollin e pastërtisë së figurës së subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se mospërmbyshja e rregullt e detyrës cenon pastërtinë e figurës së subjektit Luveda Dardha dhe shkallën e besueshmërisë së saj në zbatim të pikës 2 të nenit 4 dhe pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE TË SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

145. Rivlerësimi profesional sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016 është bazuar në raportin e përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky organ ka hartuar raportin vlerësues nr. *** prot., datë 3.11.2020, për subjektin Luveda Dardha, ku për subjektin e rivlerësimit janë evidentuar aftësi të mira profesionale organizative, etike dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, si dhe aftësi personale dhe angazhimi profesional.

Tri dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

i) Dokumenti 1 – vendimi gjyqësor civil nr. ***, datë 3.12.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, që i përket çështjes civile me nr. regj. them., ***, datë regj. 18.6.2015. Subjekti i rivlerësimit ka gjykuar si gjyqtare e vetme.

ii) Dokumenti 2 – vendimi gjyqësor civil nr. ***, datë 15.2.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, që i përket çështjes civile me nr. regj. them., ***, datë regj. 30.9.2015. Subjekti i rivlerësimit ka gjykuar si gjyqtare e vetme.

iii) Dokumenti 3 – çështja penale nr. *** regjistri themeltar, datë 6.4.2016 regjistrimi. Subjekti i rivlerësimit ka gjykuar me trup gjykues ku vetë ishte relatores (kryesues).

Komisioni vëren se bazuar në raportin e KLGJ-së, por edhe pas analizimit të dokumentacionit në tri dokumentet e paraqitura nga subjekti, nuk janë konstatuar problematika apo mangësi që çojnë në një vlerësim negativ të subjektit të rivlerësimit për kriterin profesional.

Pesë dosjet gjyqësore të përzgjedhura me short

Referuar dosjes nr. 3, që i përket çështjes civile nr. *** regjistri themeltar, datë 30.1.2014 regjistrimi¹¹, ku subjekti i rivlerësimit ka gjykuar si gjyqtare e vetme dhe dosjes nr. *** , që i përket çështjes civile nr. *** regjistri themeltar, datë 28.9.2015 regjistrimi¹², ku subjekti i rivlerësimit ka gjykuar si gjyqtare e vetme.

Komisioni vëren se bazuar në raportin e KLGJ-së, por edhe pas analizimit të dokumentacionit referuar tri dosjeve është konstatuar:

i) Në dosjen nr. 1, që i përket çështjes penale nr. *** regjistri themeltar, datë 6.4.2016 regjistrimi, ku subjekti i rivlerësimit ka gjykuar me trup gjykues ku ishte relatore nga Grupi i Punës pranë KLGJ-së është konstatuar se dorëzimi i dosjes gjyqësore dhe vendimi gjyqësor në sekretarinë gjyqësore është bërë duke tejkalar me 2 ditë afatin 5-ditor të parashikuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.

ii) Në dosjen nr. 2, që i përket çështjes penale nr. *** regjistri themeltar, datë 4.1.2016 regjistrimi, ku subjekti i rivlerësimit ka gjykuar si gjyqtare e vetme nga Grupi i Punës pranë KLGJ-së se është konstatuar dorëzimi i dosjes gjyqësore dhe vendimi gjyqësor në sekretarinë gjyqësore, duke tejkalar me 1 ditë afatin 5-ditor të parashikuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.

iii) Në dosjen nr. 5, që i përket kërkesës penale nr. *** regjistri themeltar, datë 3.3.2014 regjistrimi, ku subjekti i rivlerësimit ka gjykuar si gjyqtare e vetme nga Grupi i Punës pranë KLGJ-së se është konstatuar vetëm dorëzimi i dosjes gjyqësore dhe vendimi gjyqësor në sekretarinë gjyqësore, duke tejkalar me 1 ditë afatin 5-ditor të parashikuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.

Komisioni vëren se bazuar në raportin e KLGJ-së, por edhe në analizimin e dokumentacionit për dosjet 1, 2 dhe 5 është konstatuar se dorëzimi i dosjes gjyqësore dhe i vendimit janë bërë me vonesë duke kaluar afatin 5-ditor të parashikuar në Kodin e Procedurës Penale.

Për konstatimet e mësipërme, subjektit të rivlerësimit iu kërkuan shpjegime bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

146. Subjekti i rivlerësimit, në prapësime dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar ndër të tjera se: *“Për dosjen nr. 1[...] afati 5-ditor, për dorëzimin e dosjes së bashku me vendimin, duke u nisur nga data e shpalljes së vendimit, përfundonte në datën 24.7.2016, ku duke iu referuar kalendarit për muajin korrik 2016, afati 5-ditor ka përfunduar në ditë të diele, e cila është ditë pushimi, ku dorëzimi duhet të bëhej në datën 25.7.2016, por në këtë rast është realizuar nga sekretaria gjyqësore vetëm me një ditë vonesë, për shkakun sa më sipër. Sqarohet se dorëzimi i dosjes së bashku me vendimin nga ana ime i janë dorëzuar sekretares në afatin e*

¹¹Që u përket palëve: paditëses T. B., kundër të paditurve Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër dhe Bashkia Vau i Dejës; me objekt “pasaktësi të pjesshme të dokumentit, certifikatës së pronësisë me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, lloji i pasurisë pemëtoje, truall, ndërtesë, me sipërfaqe totale 2300 m², vendndodhja e pasurisë L., për sa i përket gjeneraliteteve, duke saktësuar nga e gabuar T. L. në reale T. B. Pasaktësi e pjesshme e AMTP-së nr. ***, nr. pasurie ***, fshati L., për sa i përket gjeneraliteteve duke saktësuar nga e gabuar T. B.”. Kjo çështje është përfunduar me vendimin nr. ***, datë 18.3.2014.

¹²Që u përket palëve: paditëses K.Gj., kundër të paditurës Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Shkodër me objekt “Njohjen e vërtetësisë së regjistrimit themeltar nr. ***, f. *** të ish-KB Qerret, fshati Q.V., për sa i përket ditëve të punës së vitit 1987 të shënuara mbi vizë, në favor të paditëses K.Gj. Njohjen e qenies në marrëdhënie pune në periudhën 1.1.1990 - 19.7.1991, pranë ish-KB Qerret, fshati Q.V., duke realizuar mesataren e ditëve të punës për gra. Kjo çështje ka përfunduar së gjykuari me vendimin nr. ***, datë 4.11.2015.

caktuar për dorëzim, pra në respektim të afatit 5-ditor, por për shkak të veprimeve administrative për përgatitjen e dosjes për dorëzim, ka rezultuar që dorëzimi në kryesekretari është realizuar vetëm me një ditë vonesë.

Për dosjen nr. 2 [...] afati 5-ditor për dorëzimin e dosjes së bashku me vendimin, duke u nisur nga data e shpalljes së vendimit, përfundonte në datën 21.2.2016, ku duke iu referuar kalendarit për muajin shkurt 2016, afati 5-ditor ka përfunduar në ditë të diele, e cila është ditë pushimi, ku dorëzimi është realizuar në ditën pasardhëse të punës, datë 22.2.2016, pra dosja konsiderohet e dorëzuar në afat. Ky rregull parashikohet në nenin 144 të Kodit të Procedurës Penale, pikat 2 dhe 3, ku parashikohet se: '2. Afatet llogariten sipas kalendarit të zakonshëm. 3. Afati i caktuar në ditë, kur mbaron në ditë pushimi ose ditë feste, shtyhet deri në ditën pasardhëse të punës ose jofestive'. Në këto kushte kur afati 5-ditor për dorëzimin e dosjes gjyqësore së bashku me vendimin ka përfunduar në ditë pushimi, dorëzimi është bërë në ditën pasardhëse të punës, pra dosja duhet konsideruar e dorëzuar brenda afatit ligjor.

Për dosjen nr. 5 [...] afati 5-ditor për dorëzimin e dosjes së bashku me vendimin, duke u nisur nga data e shpalljes së vendimit, përfundonte në datën 9.3.2014, ku duke iu referuar kalendarit për muajin mars 2014, afati 5-ditor ka përfunduar në ditë të diele, e cila është ditë pushimi, ku dorëzimi është realizuar në ditën pasardhëse të punës, datë 10.3.2014, pra dosja konsiderohet e dorëzuar në afat. Ky rregull parashikohet në nenin 144 të Kodit të Procedurës Penale, pikat 2 dhe 3, ku parashikohet se: '2. Afatet llogariten sipas kalendarit të zakonshëm. 3. Afati i caktuar në ditë, kur mbaron në ditë pushimi ose ditë feste, shtyhet deri në ditën pasardhëse të punës ose jofestive'. Në këto kushte, kur afati 5-ditor për dorëzimin e dosjes gjyqësore së bashku me vendimin ka përfunduar në ditë pushimi, dorëzimi është bërë në ditën pasardhëse të punës, pra dosja duhet konsideruar e dorëzuar brenda afatit ligjor”.

Komisioni, pasi administroi dhe vlerësoi shpjegimet e subjektit, mban qëndrimin se në konsideratë të sa parashikohet nga vendimi nr. 2 /2017 i Gjykatës Kushtetuese se: “Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe që tregojnë mungesë të aftësive profesionale”, gjetjet e raportit profesional nuk mund të shërbejnë si provë për cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë nga subjekti.

Konkluzion për vlerësimin e aftësisë profesionale

147. Trupi gjykues, bazuar në konstatimet e mësipërme, argumentet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe bazuar në kreun II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pas një analize në përputhje me ligjin nr. 84/2016, “Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konkludon se në përfundim të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit Luveda Dardha ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësisë profesionale.

DENONCIME NGA PUBLIKU

148. Ndaj subjektit të rivlerësimit Luveda Dardha janë depozituar 6 denoncime/ankesa nga publiku.

1) Denoncimi nr. *** prot., datë 7.12.2017, i shtetas P. K., e cila ndër subjekte të tjera përmend edhe subjektin Luveda Dardha për zvarritje në procese gjyqësore, por që ka bashkëngjitur vendime gjyqësore të gjykuara nga subjektet e tjera dhe jo nga subjekti Luveda Dardha.

2) Denoncimi nr. *** prot., datë 14.9.2020, i shtetasit D. P., i cili i drejton një letër subjektit të rivlerësimit dhe 10 institucioneve të tjera, ku i kërkohet të marrë parasysh prova për një proces gjyqësor që ka me një institucion, por nuk ka referuar ndonjë shkelje të subjektit të rivlerësimit.

3) Denoncimi nr. *** prot., datë 1.6.2018, i shtetases P. K., e cila ankohet për rrëzimin e kërkesës së saj “lëshim urdhërezekutimi” në cilësinë e personit të tretë në proces, pasi nuk legjitimohet në një kërkim të tillë.

4) Denoncimi nr. ***prot., datë 19.12.2018, i shtetases V. N., e cila i kërkon Komisionit të prishë vendimin e apelit, i cili ka lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë për një çështje ku denoncuesja ka qenë palë. Në këto vendime nuk rezulton të përmendet subjekti Luveda Dardha.

5) Denoncimi nr. *** prot., datë 8.1.2020, i shtetasit N. K., i cili ankohet për subjektin Luveda Dardha lidhur me çështjen penale ku denoncuesi është shpallur fajtor për një vepër penale.

6) Denoncimi nr. *** prot., datë 5.1.2021, i shtetasit Gj. N., i cili ankohet ndaj vendimit të dhënë nga subjekti i rivlerësimit dhe rrëzimin e kërkesës për rifillimin e hetimeve nga prokuroria.

149. Komisioni, pasi mori në shqyrtim denoncimet e mësipërme, konstaton se kanë lidhje me vendimmarrjen dhe themelin e çështjeve të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit, dhe, bazuar në pikën 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” Komisioni nuk ka kompetencë të gjykojë mbi korrektësinë e vendimit dhe themelit të çështjes, tagra këto në kompetencë të një gjykate më të lartë.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, rekomandimet e relatores së çështjes, pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, mori në shqyrtim pretendimet e parashtruara dhe provat e paraqitura, në vlerësimin e çështjes në tërësi, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka pasaktësi në deklaratën e pasurisë *Vetting* lidhur me burimin e krijimit të pasurive dhe mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë, në kuptim të parashikimeve të pikave 1, 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe germave “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33 dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, si dhe në vlerësimin tërësor ka cenuar besimin e publikut të drejtësia në kuptim të parashikimeve të pikës 2 të nenit 4 dhe pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

Për këto arsye,

Trupi gjykues, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe pikave 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Luveda Dardha, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjirokastrë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 11.6.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Valbona SANXHAQARI
Kryesuese

Olsi KOMICI
Relator/Kundër

Xhensila PINE
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Olsida Goxhaj